

## In the boiling water of violence

**Nothing happens immediately.**

"In a bathtub of water that heats gradually, you can boil and die without realizing it."

This description by Margaret Atwood from *The Handmaid's Tale* is the perfect metaphor for the cycle of violence against women, which is never just an isolated episode of "exhaustion," "stress," "temper," or "passion."

No! These are merely justification labels learned over the years.

It is always more than just a moment; it is a persistent, insidious approach, reinforced, validated, rewarded, or simply egregiously neglected.

Globally, **1 in 3 women** admit to having been victims of physical, sexual violence, or coercion at least once in their lives, whether by a partner or a not intimate partner.

In our region, **every month, on average 4 women have been murdered since 2020**, and over **66% feel the threat of domestic violence in their daily lives** (RCC, Securimeter 2024).

In Albania, **52.9% of women** report experiencing one or more forms of violence throughout their lives (GREVIO, 2024).

As if the classical forms of abuse and violence, inherited over generations in our society raised under the yoke of aggression, were not enough, modern times—the era of social media and unconditional freedoms without rules—have brought us an even greater threat, one that puts absolutely everyone at risk: women, men, and children alike.

It is the danger of the homogenization of abusers, the echo that violence gains from online platforms, the terrain where anonymity bullies in the most perverse forms of expression, targeting women, girls, and minors, creating a new platform for crime. The chronicles of these acts shatter the peace of each of us daily.

Albania holds a paradoxical position in the online world within the region:

**43% of citizens** consider information received from social media to be trustworthy, yet **59.2% are worried about its impact on children** (Balkan Barometer 2024).

It's no wonder, then, that Albanians also report the fastest-growing phenomenon of online violence, with **12% of girls** and **5% of boys** experiencing it.

It is true that violence exists in every corner of the world, sometimes overtly, sometimes camouflaged—with atrocities, murders, rapes, injuries, threats, selective abortions, stalking, child marriages, and all kinds of discrimination against women and girls, regardless of their economic position or social status.

But on a day like today, we must reflect more deeply: **violence cannot be solve by the victims alone.**

We must think beyond the pathetic mediocrity of social media posts about how the cycle of violence—misogyny, the daily sensationalism that portrays women and girls as objects of sexual desire for clicks, and the insistence that boys be raised and presented in society as strong and vengeful men according to tradition—repeats itself and keeps generations, not just violent individuals, under pressure.

Violence is merely the symptom of a sick society, the anemia of its economic, political, and familial systems.

But, as in Atwood's metaphor: **Nothing happens immediately.**

"In a bathtub of water that heats gradually, you can boil and die without realizing it."

## **Albanian version**

### **Asgjë nuk ndodh menjëherë.**

Në një vaskë me ujë që nxehet gradualisht, mund të vdesësh pa e kuptuar."

Ky përshkrim i Margaret Atwood nga "*Rrëfenja e Shërbëtores*" është metafora e përkryer për ciklin e dhunës ndaj grave i cili nuk është kurrë një episod i izoluar shpërthimi nga "lodeja", "stresi", "nervat" apo "pasioni".

Jo! Këto janë vetëm etiketat e justifikimit të mësuara ndër vite.

Është gjithmonë më shumë se një moment, është një qasje këmbëngulëse e tinëzare, e përforcuar, vlerësuar, shpërblyer ose thjesht e neglizhuar keqas.

### **1 në 3 gra në nivel botëror pranojnë se kanë qenë të paktën një herë në jetë pre e dhunës fizike, seksuale apo presionit qoftë nga partneri ose një i panjohur.**

Në Ballkanin tonë çdo muaj, **prej 2020 janë vrarë mesatarisht 4 gra dhe me shumë se 66% e ndjejnë në lekurë kërcënimin e dhunës në familje.** (RCC, Securimeter 2024)

Në Shqipëri 52.9% e grave raportojnë një ose më shumë forma të dhunës gjatë gjithë jetës së tyre. (Grevio, 2024) Sikur të mos mjaftonin format klasike të abuzimit e dhunës, të trashëguara ndër vite në shoqërinë tonë, të rritur nën thundrën e përdhunës, kohët moderne, kohët e medias sociale dhe të lirive pa kushte e rregulla që ato kanë, na kanë sjellë një kërcënim edhe më të madh, përballë të cilit jemi të rrezikuar, absolutisht, të gjithë, gra, burra e fëmijë.

Është rreziku i homogjenitetit të dhunuesve, i jehonës që dhuna merr nga dritaret online, terreni ku anonimati bullizon me format me perverse të të shprehurit, kryesisht gratë, vajzat e të miturit duke krijuar platformën e re të kimit, kronikat e të cilit po shëmbin çdo ditë qetësinë e secilit prej nesh.

Shqipëria është vendi i parë në rajon me një sjellje paradoksale për botën online.

43% e qytetarëve e konsiderojnë të besueshëm informacionin që marrin nga mediat sociale, por ama 59,2% janë të trembur për pasojat që ky informacion ka tek fëmijët. (Balkan Barometer 2024)

Ndaj nuk më bën çudi që edhe rritjen më të shpejtë të fenomenit të dhunës online e raportojnë po shqiptarët me 12% të vajzave dhe 5% të djemve.

E vërtetë që dhuna është prezente në çdo cep të botës, diku hapur e diku e kamufluar-me makabritete, vrasje, përdhunime, plagosje, kërcënime, abort selektiv, përndjekje, martesë në moshë të vogël, dhe diskriminim gjithëfarësoj të grave e vajzave pavarësisht pozicionit të tyre ekonomik dhe statusit të tyre shoqëror.

Por në një ditë si sot, duhet menduar pak më gjatë se **dhuna nuk është hall që mund ta zgjidhin viktimat.**

Duhet menduar tej mediokritetit patetik të postimeve, se si cikli i dhunës, - misogjinia, tellallizimi i përditshëm se vajzat e gratë duhen parë e gjykuar siç i duan klikimet- objekte seksi dhe djemtë duhen rritur e shfaqur në rrugë, shkollë, punë e familje, siç i do zakoni, burra të fortë e hakmarrës, - përsëritet e mban nën presion breza jo vetëm individë të dhunshëm.

Dhuna është vetëm simptoma e lëngimit të shoqërisë, anemisë të sistemit ekonomik, politik dhe familjar.

Por si në metaforën e Atwood-it: **“Asgjë nuk ndodh menjëherë. Në një vaskë me ujë që nxeht gradualisht, mund të valosh e të vdesësh pa e kuptuar.”**